


Sundimi i Ligjit në kontekst të anëtarësimit në BE

— dokument tremujor —

janar - mars 2024



Instituti
për
politikë
evropiane.
Shkup



Ky projekt finansohet nga Bashkimi Evropian

Sundimi i ligjit në kontekst të anëtarësimit në BE

Dokument tremujor janar - mars 2024

Botues:

Instituti për politikë evropiane - Shkup

Për botuesin:

Dr. Simonida Kacarska

Redaktorët:

Dr. Simonida Kacarska

Dr. Ardita Abazi Imeri

Autorë:

Angela Delevska

Beba Zhagar

Juljana Karai

Cvetanka Aleksandrovska

Përkthim nga gjuha angleze në gjuhën shqipe:


Blerina Starova Zlatku

Dizajn grafik:

Relativ

Shkup, 2024

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Ndërtojmë urë për një të ardhme të përbashkët: Sundimi i së drejtës në drejtim të aderimit në BE”, i financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe assesit nuk mund të konsiderohet se i përfaqëson qëndrimet dhe pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Ky dokument paraqet zhvillimet kryesore në lidhje me sundimin e ligjit në kontekst të anëtarësimit në BE në Maqedoninë e Veriut për periudhën janar – mars 2024. Ai përfshin monitorimin e themeleve të anëtarësimit në BE, duke përfshirë zhvillimet kryesore në funksionimin e institucioneve demokratike, reformën e administratës publike, dhe Kapitullin 23: Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore.

Zhvillimet kryesore

- » Më 28 janar u formua një qeveri tranzitore, me kryeministrin e parë shqiptar etnik;
- » Kandidatët për zgjedhjet e ardhshme presidenciale u shpallën në shkurt. Shtatë prej tyre arritën të mbledhin 10,000 nënshkrimet e nevojshme për të hyrë në garën presidenciale;
- » Përbërja e KSHZ-së përfundoi më 28 shkurt me zgjedhjen e anëtarit të shtatë të propozuar nga Aleanca Evropiane për Ndryshim;
- » U miratuan ndryshime në Kodin Zgjedhor, duke lejuar përdorimin e dokumenteve me emrin e vjetër shtetëror për votim, riorganizimin e procesit të regjistrimit të votuesve dhe vendosjen e kuotave më të larta të nënshkrimit për kandidatët e pavarur, një veprim që tërhoqi kritika dhe thirrje për ndryshim nga të pavarurit;
- » Koalicione të ndryshme parazgjedhore u formuan për zgjedhjet parlamentare, me agjenda dhe udhëheqje të ndryshme, duke krijuar themelet për një peizazh konkurrues zgjedhor;
- » Propozimi për ndryshime në Ligjin për Masat Kufizuese që synon zgjerimin e bazave për vendosjen e masave ndaj individëve në listën e zezë u paraqit, por ende nuk është miratuar nga Kuvendi;
- » Sfidat vazhduan në tranzicionin e dokumenteve kombëtare sipas Marrëveshjes së Prespës, duke shkaktuar konfuzion dhe shqetësim midis qytetarëve;
- » Shpallja e zgjedhjeve të ardhshme presidenciale dhe parlamentare në Kuvend ngriti shqetësime në lidhje me pavarësinë e autoritetit gjyqësor, veçanërisht në lidhje me zbatimin e Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit. Ndërsa Këshilli Gjyqësor vendosi të ndalë përkohësisht proceset për përzgjedhjen dhe vlerësimin e llogaridhënies së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve, Këshilli i Prokurorëve Publikë nuk ndërmori veprime të tilla. Gjithashtu, Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë mori ankesë nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në lidhje me provimet në vazhdim për pranimin e dëgjuesve të gjeneratës së IX, duke vënë në dukje sfida më të gjera brenda institucioneve përkatëse;
- » Miratimi i Parlamentit të ndryshimeve në gjashtë ligje, që prekin pagat e mbi 1.000 zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar, duke përfshirë poste të larta si presidenti, deputetët, ministrat, gjyqtarët dhe prokurorët publikë, ka shkaktuar kundërshtime nga organet dhe shoqatat kryesore gjyqësore. Këto ndryshime ndalojnë rritjen e mëtejshme të pagave duke ruajtur rritjen thelbësore të vitit të kaluar, duke ngritur shqetësime për pavarësinë financiare të gjyqësorit dhe duke ndikuar në aspekte të ndryshme të roleve dhe përgjegjësisë të tyre;
- » Miratuar në dhjetor 2023, Strategjia e Zhvillimit të Gjyqësorit për vitin 2024–2028 pa themelimin e një Këshilli për të mbikëqyrur lansimin e tij, duke siguruar respektimin e Planit të Veprimit, monitorimin e prioriteteve dhe vlerësimin e arritjeve;
- » Rivendosja e kryetares të shkarkuar të Këshillit Gjyqësor ka nxitur përpjekjet për të trajtuar rekomandimet e misionit vlerësues të kolegëve të BE-së përmes miratimit të një plani veprimi, të shoqëruar me rifillimin e projekteve të ndaluara më parë nga misionet diplomatike;
- » Maqedonia e Veriut u rendit e 76-ta në botë me 42 pikë në Indeksin e fundit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International, me ndryshimet e miratuara në Kodin Penal në vitin 2023 të përmendura si të dëmshme për luftën kundër korrupsionit;
- » Mandati i përbërjes së re të KSHPK-së i përbërë nga katër auditues, dy punonjës të KSHPK-së, dhe një gjyqtar filloi më 8 shkurt;
- » Kuvendi miratoi Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Zbatimin e Sanksioneve, me qëllim të zgjidhjes së problemeve të sigurisë në burgjet, për të krijuar një mjedis më të sigurt në burgje, si dhe siguri të përgjithshme në shtet, e cila duhet të arrihet duke krijuar një Njësi të Inteligjencës së Burgjeve dhe një Njësi të Ndërhyrjes;
- » U miratua Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale, duke shfuqizuar kështu ndalimin e reklamimit shtetëror në media dhe duke futur dy kapituj të rinj mbi fushatat shtetërore në nivel shtetëror dhe fushatat shtetërore në nivel lokal, duke përfshirë gjithsej 12 nene të reja që rregullojnë këtë çështje;
- » Në mes të marsit, Kuvendi miratoi Ligjin e ri për Drejtësinë për Fëmijët, i cili prezanton dhe rregullon drejtësinë restauruese dhe rregullon në mënyrë specifike të drejtën e kompensimit të një fëmije viktimë, ndër të tjera;
- » Në fund të muajit mars, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi dispozitën e Ligjit për Mbështetjen Financiare të Kategorive Sociale të Cenueshme të Qytetarëve, që pengon personat mbi 65 vjeç të marrin kompensim për shkak të aftësisë së kufizuar;
- » Nga fundi i marsit, Gjykata Themelore në Negotinë miratoi aktgjykimin e parë në sistemin gjyqësor maqedonas që përcakton gjuhën e urrejtjes ndaj personave LGBTI+ në mediat sociale.



Lista e shkurtesave

ASH	Aleanca për Shqiptarët
ASHMAA	Agjencia e Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale
SHGM	Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë
AGJPP	Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë
PTHPNKOK	Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
KPMD	Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi
KPPRMV	Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut
OSHC	Organizatata e shoqërisë civile
BDI	Bashkimi Demokratik për Integrim
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ)
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
MVZH	Misioni Vëzhgues për Zgjedhjet
QEDR	Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve
BE	Bashkimi Evropian
GRECO	Grup i Shteteve kundër Korrupsionit
GROM	Opsioni qytetar për Maqedoninë
AI	Agjencia e Inteligjencës
TIK	Këshilli për Koordinimin e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit në Gjyqësor
LGBTI+	Komunitetet lezbike, homoseksuale, biseksuale, trans dhe interseksuale
MEPSO	Operator i sistemit elektrotransmetues i Republikës së Maqedonisë së Veriut
MSHIA	Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës
KOM	Kisha Ortodokse Maqedonase
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
ODIHR	Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut
UÇK	Ushtria Çlirimtare Kombëtare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
AMDP	Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
PP	Zyra e Prokurorisë Publike
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
KSHZ	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
KEMM	Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni
KSHPK	Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
LSDM	Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë
KSHZ	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
SPGPM	Sindikata e Pavarur e Gazetarëve dhe Punonjësve Mediatik
UNICEF	Fondi i Emergjencës i Kombeve të Bashkuara për Fëmijet
VMRO-DPMNE	Organizata e brendshme revolucionare maqedonase – Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas
ZNAM	Për Maqedoninë Tonë



Përmbajtje

Funksionimi i institucioneve demokratike	6
Zgjedhjet.....	7
Parlamenti.....	9
Qeverisja.....	10
Shoqëria civile.....	11
Mbikëqyrja Civile e Sektorit të Sigurisë/Inteligjencës.....	11
Reforma e Administratës Publike.....	12
Kapitulli 23	13
Funksionimi i Gjyqësorit.....	14
Dokumente strategjike.....	14
Organet menaxhuese.....	14
Pavarësia dhe paanshmëria.....	15
Llogaridhënia.....	16
Profesionalizmi dhe kompetenca.....	16
Cilësia e Drejtësisë.....	17
Efikasiteti.....	17
Luftra Kundër Korrupsionit.....	19
Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit.....	19
Prokuroria Publike.....	20
Kuadri Ligjor.....	22
Të drejtat themelore.....	23
Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.....	23
Avokati i Popullit.....	24
Burgu dhe objektet e paraburgimit.....	24
Mbrojtja e të dhënave personale.....	25
Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë.....	26
Liria e shprehjes.....	26
Të drejtat e fëmijës.....	27
Grupet e cënueshme dhe parimi i mosdiskriminimit.....	28
Gjinia.....	29
Gjuha e urrejtjes.....	29
LGBTI+.....	30
Romët.....	30

Funksionimi
i institucioneve
demokratike



Zgjedhjet

Viti filloi me pritjen e ndryshimeve të dukshme politike në Maqedoninë e Veriut. Zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare të dakorduara në dhjetor 2023 shënojnë një moment historik si të parat që ndodhin në fund të një mandati të rregullt në 17 vjet. Zgjedhjet e fundit të tilla parlamentare u mbajtën në vitin 2006. Këto ndryshime të parashikuara filluan më 28 janar me zgjedhjen e një qeverie të re tranzitore-teknike nga Parlamenti në Shkup, e cila do të mbetet në fuqi deri në zgjedhjet e planifikuara për 8 maj.¹

Zgjedhjet e ardhshme presidenciale paraqesin një grup të larmishëm kandidatësh nga subjekte të ndryshme politike. Levica kandidoi një profesore të respektuar nga Univerziteti Sh. Kirili dhe Metodi,² ndërsa Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) zgjodhi nënkryetarin dhe ministrin aktual të punëve të jashtme.³ Presidenti aktual u caktua si kandidat nga Lidhja Socialdemokratike e Maqedonisë (LSDM), dhe Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) zgjodhi një profesoreshë të drejtësisë, anëtare të Parlamentit dhe ish-kandidate presidencial nga zgjedhjet e vitit 2019.⁴ Përveç kësaj, partitë më të vogla kanë paraqitur kandidatë me prejardhje dhe përkatësi të ndryshme. Këto përfshijnë kryetarin e komunës së Kumanovës nga partia politike Për Maqedoninë Tonë (ZNAM), kryetarin e komunës së Karposhit dhe kryetarin e Opcionit Qytetar për Maqedoninë (GROM), një avokat i të drejtave të njeriut është miratuar nga Bashkimi Demokratik Boshnjak dhe një anëtar i partisë së krahut të djathtë E Djathta. Një kandidaturë e pavarur nga një profesor universiteti dhe specialist i sëmundjeve infektive shton diversitetin e mëtejshëm në peizazhin zgjedhor.⁵

Mes këtyre kandidimeve, Aleanca për Shqiptarët (ASH) u përball me mosmarrëveshje të brendshme në lidhje me strategjinë zgjedhore, veçanërisht në lidhje me koalicionet e mundshme me grupe të tjera politike.⁶ Ky debat çoi në një ndarje brenda partisë, duke rezultuar përfundimisht në zgjedhjen e liderit të ASH-së si kandidat presidencial për Aleancën Evropiane për Ndryshim.⁷ Partia kështu përfundoi e ndarë në dy fraksione: njëra e rreshtuar me opozitën shqiptare brenda Aleancës Evropiane për Ndryshim⁸ dhe tjetra me Frontin Evropian të udhëhequr nga BDI.⁹

Pavarësisht spektrit të gjerë të kandidatëve të propozuar, vetëm shtatë mblodhën 10,000 nënshkrimet e kërkuara për të hyrë në garën presidenciale. Këta kandidatë përfaqësojnë ZNAM, BDI, Aleancën Evropiane për Ndryshim, Levicën, GROM, VMRO-DPMNE dhe LSDM.¹⁰

1. 'Sot u shpallën zgjedhjet e 7-ta presidenciale dhe të 11-të parlamentare në Maqedoninë e pavarur (Денеска се распишуваат 7-те претседателски избори и 11-те парламентарни во независна Македонија)', *Tellma*, 12 shkurt 2024, <https://telma.com.mk/2024/02/14/deneska-se-raspishuvaat-7-te-pretседателски-izbori-i-11-te-parlamentarni-vo-nezavisna-makedonija/>.

2. 'Biljana Vankovska është candidate presidenciale e Levicës (Билјана Ванковска е претседателски кандидат од Левица)', Radio Evropa e Lirë, 7 shkurt 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32809078.html>.

3. 'Bujar Osmani do të jetë karta e BDI-së në zgjedhjet për president të Maqedonisë (Бугар Османи ќе биде адут на ДУИ на изборите за претседател на Македонија)', *Tellma*, 22 shkurt 2024, <https://telma.com.mk/2024/02/22/bujar-osmani-ke-bide-adut-na-dui-na-izborite-za-pretседател-na-makedonija/>.

4. 'Zgjedhjet presidenciale: Pendarovski kundër Siljanovskës për herë të dytë, Stevçe Jakimovski shpalli kandidaturën e tij, Bujar Osmani do të kandidojë nesër në listën në të cilën Vankovska tashmë është duke pritur (Претседателски избори: Пендаровски против Силјановска по вторпат, Стевче Јакимовски објави кандидатура, Бугар Османи ќе истрча утре на листата на која веќе ги чека Ванковска)', *Tellma*, 21 shkurt 2024, <https://telma.com.mk/2024/02/21/pretседателски-izbori-pendarovski-protiv-siljanovska-po-vtorpat-stevche-jakimovski-objavi-kandidatura-bujar-osmani-ke-istrcha-ut-re-na-listata-na-koja-veke-gi-cheka-vankovska/>.

5. 'Askush nuk dëshiron të mbetet pa kandidat presidencial në zgjedhje të dyfishta (Никој не сака да остане без претседателски кандидат на двојни избори)', Radio Evropa e Lirë, 22 shkurt 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/nikoj-ne-saka-da-ostane-bez-pretседателски-kandidat-na-dvojni-izbori/32830800.html>.

6. 'Zgjerohet përçarja mbi zgjedhjet në partinë shqiptare në Maqedoninë e Veriut', *Balkan Insight*, 9 shkurt 2024, <https://balkaninsight.com/2024/02/09/rift-over-elections-widens-in-north-macedonia-albanian-party/>.

7. 'Arben Taravari është kandidati presidencial i opozitës shqiptare (Арбен Таравари е претседателскиот кандидат на албанската опозиција)', Radio Evropa e Lirë, 15 shkurt 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32820748.html>.

8. 'Taravari në lidhje me përçarjen në Aleancën për Shqiptarët: E lëmë gjykatën të vendosë (Таравари за поделбата во Алијанса за албанците: Оставиме судот да одлучи)', *360 Stepeni*, 25 shkurt 2024, <https://360stepeni.mk/taravari-za-podelbata-vo-alijansa-za-albancite-ostavimе-sudot-da-odлучi/>.

9. 'Ahmeti dhe Sela nënshkruan marrëveshjen e koalicionit për pjesëmarrje të përbashkët në zgjedhjet parlamentare (Ахмети и Села го потпишаа коалицискиот договор за заеднички настап на парламентарните избори)', *360 Stepeni*, 30 mars 2024, <https://360stepeni.mk/ahmeti-i-sela-go-potpishaa-koalitsiskiot-dogovor-za-zaednichki-nastap-na-parlamentarnite-izbori/>.

10. 'Shtatë kandidatë hyjnë zyrtarisht në garën për president të Maqedonisë (Седум кандидати официјално влегуваат во трка за претседател на Македонија)', *Атон*, 9 mars 2024, <https://a1on.mk/macedonia/sedum-kandidati-oficialno-vleguvaat-vo-trka-za-pretседател-na-makedonija/>.

Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) në Maqedoninë e Veriut pa zhvillime në fund të shkurtit dhe në fillim të marsit. Parlamenti miratoi propozimin e Aleancës Evropiane për Ndryshim për një anëtar të ri të KSHZ-së më 28 shkurt, duke përfunduar përbërjen e komisionit pas disa muajsh vakancë.¹¹ Menjëherë pas kësaj, Presidenti i KSHZ-së propozoi ndryshimin e Kodit Zgjedhor për të lejuar votimin në zgjedhjet e ardhshme duke përdorur dokumentet me emrin e vjetër të shtetit¹² në përgjigje të kaosit të shkaktuar nga afati i përcaktuar në Marrëveshjen e Prespës. Marrëveshja përcaktonte se dokumentet me emrin e vjetër të shtetit do të pushonin së qeni të vlefshme nga 12 shkurti, duke çuar në konfuzion të gjerë pasi shumë qytetarë nuk kishin përfunduar ende procesin e tranzicionit për dokumentet e tyre. Kuvendi miratoi ndryshimet, të cilat gjithashtu rafinuan regjistrimin e votuesve, hoqën kufizimet bazuar në dokumente të skaduara dhe sqaruan procedurat për përfshirjen në listat zgjedhore për ata që mbushin 18 vjeç midis raundeve zgjedhore.¹³ Për më tepër, ndryshimet rritën kuotat e nënshkrimeve të kërkuara për pjesëmarrjen e kandidatëve të pavarur në zgjedhje, duke kërkuar tani nënshkrime nga të paktën 1% e votuesve të regjistruar në zonën e tyre zgjedhore.¹⁴ Të pavarurit kritikuan ndryshimet, duke bërë thirrje për heqjen e tyre dhe duke theksuar vështirësitë në mbledhjen e nënshkrimeve përmes zyrave të KSHZ-së për shkak të disponueshmërisë së tyre të kufizuar në komuna, për të cilën ata argumentojnë se mbetet çështje edhe pas ndryshimeve.¹⁵

Në fund të marsit, partitë në Maqedoninë e Veriut finalizuan listat e tyre të kandidatëve parlamentar dhe koalicionet parazgjedhore për zgjedhjet e ardhshme parlamentare filluan të marrin formë. Këto koalicione përfshijnë “Koalicionin për të Ardhmen Evropiane” të udhëhequr nga LSDM, “Maqedonia Jote” të udhëhequr nga VMRO–DPMNE, “Me guxim për Maqedoninë” të udhëhequr nga GROM, “Fronti Evropian” të udhëhequr nga BDI dhe “VLEN” nga opozita shqiptare, Aleanca Evropiane për Ndryshim. ZNAM dhe LEVICA deklaruan pjesëmarrjen e tyre të pavarur në zgjedhjet parlamentare.¹⁶ Njëkohësisht, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) rregulloi rendin e votave të kandidatëve presidencialë përmes një shorti të rastësishëm dhe konfirmoi përfundimin e inspektimit publik të listës zgjedhore. Përveç kësaj, u njoftua se votuesit nga diaspora do të merrnin pjesë ekskluzivisht në zgjedhjet e ardhshme presidenciale. Ky vendim u mor për shkak se numri i votuesve të regjistruar për zgjedhjet parlamentare nuk plotësonte pragun e kërkuar ligjor.¹⁷

11 ‘Përfundoi përbërja e KSHZ-së, Abdush Demiri u zgjodh anëtar i Komisionit (Комплетиран составот на ДИК, избран Абдуш Демири за член на Комисијата), 24.Мк, 28 shkurt 2024, <https://24.mk/details/kompletiran-sostavot-na-dik-izbran-abdush-demiri-za-chlen-na-komisijata>.

12 ‘KSHZ propozon një dispozitë tranzitore në Kodin Zgjedhor që do të lejojë votimin me dokumentet e vjetra të vlefshme (ДИК предлага преодна одредба во Изборниот законик со која ќе може да се гласа со старите важечки документи), Radio Evropa e Lirë, 4 mars 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32847280.html>.

13 ‘Votimi do të bëhet gjithashtu me “dokumente të pavlefshme”, Kuvendi votoi për ndryshimet në Kodin Zgjedhor (Ќе се гласа и со „неважечки документи“, Собранието изгласа измени на Изборниот законик), Radio Evropa e Lirë, 7 mars 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32852021.html>.

14 ‘Ndryshimet në Kodin Zgjedhor rritën kuotat e nënshkrimeve të qytetarëve për pjesëmarrjen e kandidatëve të pavarur në zgjedhje (Измените на Изборниот законик ги зголемија квотите на граѓански потписи за учество на независни кандидати на изборите), 360 Stepeni, 8 mars 2024, <https://360stepeni.mk/izmenite-na-izborniot-zakonik-gi-zgolemija-kvotite-na-graganski-potpisi-za-uchestvo-na-nezavisni-kandidati-na-izborite/>.

15 ‘Kandidatët e pavarur me reagim ndaj ndryshimeve në Kodin Zgjedhor: Partitë bllokuan pjesëmarrjen tonë në të gjitha zgjedhjet pasuese me procedurë të shkurtuar (Независните кандидати со реакција на измените на Изборниот законик: Партиите по скратена постапка го блокираа нашето учество на сите наредни избори), 360 Stepeni, 11 mars 2024, <https://360stepeni.mk/nezavisnite-kandidati-so-reaktsija-na-izmenite-na-izborniot-zakonik-partiite-po-skratena-postapka-go-blokiraa-nasheto-uchestvo-na-site-naredni-izbori/>.

16 ‘Pesë koalicione parazgjedhore janë përcaktuar më pak se një javë para fillimit të fushatës zgjedhore (Дефинирани пет предизборни коалиции на помалку од една недела до почетокот на изборната кампања), Kanal 5, 30 mars 2024, <https://kanal5.com.mk/definirani-pet-predizborni-koalicii-na-pomalku-od-edna-nedela-do-pochetokot-na-izbornata-kampanja/a633006>.

17 ‘KSHZ përcaktoi rendin e votimit për zgjedhjet e ardhshme presidenciale (ДИК го утврди редоследот на гласачкото ливче за претстојните претседателски избори), Kanal 5, 25 mars 2024, <https://kanal5.com.mk/dik-go-utvr-di-redosledot-na-glasachkoto-livche-za-pretstojnite-pretседателски-izbori/>.

Parlamenti

Gjatë seancës së tij fillestare të vitit, Këshilli i Kanalit të Parlamentit i Maqedonisë së Veriut miratoi Rregulloren e Punës, Programin Vjetor dhe Planin e Përbajtjes 2024, së bashku me Planin Financiar dhe të Investimeve për të njëjtin vit. Programimi synon të arrijë disa objektiva, duke përfshirë informimin e qytetarëve për aktivitetet e përditshme të Parlamentit, paraqitjen e propozim-ligjeve dhe dekretive legjislative dhe kryerjen e intervistave me drejtuesit e Parlamentit, deputetët dhe përfaqësuesit e tjerë të zgjedhur. Për më tepër, gjatë periudhës provë gjashtëmujore të mandatuar nga Kodi Zgjedhor, Kanali Parlamentar do të bashkëpunojë me Radiotelevizionin e Maqedonisë për të transmetuar prezantime politike falas nga kandidatët zgjedhorë.¹⁸

Kryetari në largim i Parlamentit, duke përfunduar mandatin e tij të dytë, zhvilloi një takim protokollar me ambasadorët rezident të Shteteve Anëtare të BE-së dhe zëvendës ambasadorët nga SHBA, Britania e Madhe dhe Delegacioni i BE-së në Shkup. Ai paraqiti një raport të mandatit të tij si Kryetar i Parlamentit në këtë takim.¹⁹ Gjithashtu, ai e ndau këtë raport në një konferencë përfundimtare me gazetarët²⁰ para se të tërhiqej më 15 janar për të marrë rolin e Kryeministrit në qeverinë tranzitore.²¹ Pozicioni i tij u pasua nga një anëtar i Parlamentit nga LSDM.²²

Më 28 mars, Parlamenti filloi seancën e tij të fundit të re në këtë përbërje parlamentare,²³ gjatë së cilës miratoi deklaratën që shënon përvjetorin e katërt të anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO dhe 75 vjetorin e formimit të Aleancës. Kryetari i Parlamentit theksoi se miratimi i deklaratës pasqyron një angazhim për të kontribuar ndjeshëm në paqen dhe stabilitetin rajonal dhe global.²⁴

18 'Kanali Parlamentar me një skemë të re programore: Këshilli miratoi aktet për fillimin e programit (Собранискиот канал со нова програмска шема: Советот ги усвои актите за start на програмата)', Faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 11 janar 2024, <https://www.sobranie.mk/ns-newsarticle-sobraniskiot-kanal-so-nova-programaska-sema-sovetot-gi-usvoi-aktite-za-start-na-programata.nspх>.

19 'Kryetari Xhaferi prezantoi raportin e mandatit para ambasadorëve të shteteve anëtare të BE-së, Shteteve të Bashkuara, Mbretërisë së Bashkuar dhe Delegacionit të BE-së (Претседателот Џафери го претстави мандатниот извештај пред амбасадорите на земјите членки на ЕУ, САД, Обединетото Кралство и Delegацијата на ЕУ)', Uebfaqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 23 janar 2024, <https://www.sobranie.mk/ns-newsarticle-pretsetelot-daferi-go-pretstavi-mandatniot-izvesti-pred-ambasadorite-na-zemite-clenki-na-eu-sad-edinetoto-kralsto-i-delegacij-na-eu.nspх>.

20 'Presidenti Xhaferi paraqet raportin për këtë mandat në konferencën përfundimtare për shtyp (Претседателот Џафери го презентира извештајот за овој mandat на завршниот брифинг со новинарите)', Faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 24 janar 2024, <https://www.sobranie.mk/ns-newsarticle-pretsetelot-daferi-go-prezentira-izvestajot-za-ovoj-mandat-na-zavrzniot-brifing-so-novinarite.nspх>.

21 'Talat Xhaferi dha dorëheqjen nga posti i kryetarit të Parlamentit (Талат Џафери поднесе оставка од претседателската функција во Собранието)', 360 Stepeni, 25 janar 2024, <https://360stepeni.mk/talat-dhaferi-podnese-ostavka-od-pretsetatelskata-funktsija-vo-sobranieto/>.

22 'Jovan Mitreski mori postin e kryetarit të Parlamentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Јован Митрески ја презеде функцијата претседател на Собранието на Република Северна Македонија)', Faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 26 janar 2024, <https://www.sobranie.mk/ns-newsarticle-jovan-mitreski-ja-prezede-funkcijata-pretsetel-na-sobranieto-na-republika-severna-makedonija.nspх>.

23 'Në Parlament, seanca e fundit e re në këtë përbërje parlamentare (Во Собранието последна нова седница во овој парламентарен состав)', Nova Makedonija, 28 mars 2024, <https://novamakedonija.com.mk/featured/vo-sobranieto-posledna-nova-sednica-vo-ovoj-parlamentaren-sostav/>.

24 'Asambleja miratoi një deklaratë për të shënuar katër vjet të anëtarësimit në NATO (Собранието усвои декларација за одбележување четири години од членството во НАТО)', Sloboden Peçat, 28 mars 2024, <https://www.slobodenpecat.mk/sobranieto-usvoi-deklaracija-za-odbelezuvanje-chetiri-godini-od-chlenstvoto-vo-nato/>.

Qeverisja

Pasi qeveria njoftoi në dhjetor qëllimin e saj për të futur legjislacionin që lejon veprime kundër individëve të futur në listën e zezë nga Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare, Ministria e Punëve të Jashtme propozoi ndryshime në Ligjin për Masat Kufizuese në janar.²⁵ Këto ndryshime synojnë të përfshijnë korrupsionin dhe shpërdorimin e detyrës si arsye shtesë për vendosjen e masave të tilla, duke parandaluar kështu individët në listën e zezë të mbajnë poste publike ose të marrin pjesë në tendera. Megjithatë, ndryshimet aktualisht janë në pritje të miratimit në Parlament.²⁶

Qeveria tranzitore e zgjedhur më 28 janar, pas disa javësh mosmarrëveshje midis qeverisë dhe opozitës, shënon rastin e tretë të një qeverie të tillë në historinë e vendit. Pavarësisht marrjes së kontrollit të disa ministrive dhe emërimit të disa zëvendësministrave, partia kryesore e opozitës nuk pranoi të mbështeste qeverinë tranzitore për shkak të kundërshtimeve në lidhje me ngritjen e Kryetarit të Parlamentit në rolin e Kryeministrit. Megjithatë, qeveria tranzitore u formua. Emërimi i ish-kryetarit të parlamentit si kryeministër shënon një moment historik, pasi ai është individ i parë me etni shqiptare që mban pozicionin në historinë e Maqedonisë së Veriut.²⁷

Konfliktet e brendshme brenda në ASH çuan në shkarkimin e dy ministrave (Ministrit të Shëndetësisë dhe Ministrit të Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës) të cilët mbështetën përafrimin me opozitën shqiptare. Kryeministri sqaroi se vendimi nuk u bazua në performancën e tyre profesionale, por në shmangien e dy subjekteve opozitare brenda qeverisë teknike.²⁸

Sfida të rëndësishme u shfaqën në tranzicionin e dokumenteve kombëtare për të pasqyruar emrin e ri të shtetit para afatit të 12 shkurtit të përcaktuar nga Marrëveshja e Prespës. Pas afatit, shumë qytetarë e gjetën veten pa dokumente të përditësuara, duke çuar në konfuzion dhe shqetësime në lidhje me gjobat e mundshme dhe qasjen e kufizuar në shërbime.²⁹ Fluksi i kërkesave për rinovim mbingarkoi autoritetet, duke bërë që Ministria e Brendshme të krijojë lehtësira të veçanta për të trajtuar çështjen.³⁰

Në janar, u miratua Strategjia Kombëtare për Shëndetin Mendor të të Rinjve 2024-2026,³¹ dhe në shkurt, u miratua Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2024-2044, duke përshkruar përparësitë kryesore për zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor.³²

Në fund të shkurtit, u prezantuan ndryshime në Ligjin për Shërbimet Mediatike Audio dhe Audiovizuale, duke lejuar fushatat mediatike të financuara nga shteti dhe duke përmbysur ndalimin e reklamave të financuara nga shteti të zbatuara në vitin 2018. Këto ndryshime ngritën shqetësime në lidhje me pavarësinë

25 'Qeveria harmonizoi ndryshimet e propozuara në Ligjin për Masat Kufizuese dhe i dorëzoi ato në Parlament (Vladata ги усогласила предлог-измените на Законот за рестриktivни мерки и ги доставила до Собранието), 360 Stepeni, 26 janar 2024, <https://360stepeni.mk/vladata-gj-usoglasila-predlog-izmenite-na-zakonot-za-restrktivni-merki-i-gi-dostavila-do-sobranieto/>.

26 'Ligji për Masat Kufizuese ka "ngecur" në Parlament (Во Собранието "заглавен" Законот за рестриktivни мерки), Kanal 5, 27 mars 2024, <https://kanal5.com.mk/vo-sobranieto-zaglavlen-zakonot-za-restrktivni-merki/a632531>.

27 'Parlamenti i Maqedonisë zgjodhi qeverinë tranzitore (Македонското Собрание ја изгласа техничката влада), Radio Evropa e Lirë, 28 janar 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/se-izbira-tehnicka-vlada-djaferi-veti-odgovornost-i-transparentnost-/32795100.html>.

28 'Fatmir Mexhiti dhe Azir Aliu nuk janë më ministra, Parlamenti votoi për shkarkimin e tyre (Фатмир Меџити и Азир Алиу веќе не се министри, Собранието гласаше за нивно разрешување), 360 Stepeni, 10 shkurt 2024, <https://360stepeni.mk/fatmir-medhiti-i-azir-aliu-veke-ne-se-ministri-sobranieto-glasashe-za-nivno-razreshuvane/>.

29 'A është e mundur të zgjatet afati për ndryshimin e dokumenteve personale? (Можно ли е продолжување на рокот за промена на личните документи?), Radio Evropa e Lirë, 10 janar 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/mozhno-li-e-prodolzhuvanje-na-rokot-za-promena-na-lichnite-dokumenti-/32768607.html>.

30 'Pritja për pasaporta të reja është më e gjatë se 15 ditët ligjore (Се чека повеќе од законските 15 дена за новите пасоши), Radio Evropa e Lirë, 22 janar 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/se-cheka-povekje-od-zakonskite-15-dena-za-novite-pasoshi/32786717.html>.

31 'Qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare për Shëndetin Mendor të të Rinjve 2024-2026 (Vladata ја усвои Националната стратегија за mentalno-zdravje na mladi 2024 – 2026), Radio MOF, 17 janar 2024, <https://www.radiomof.mk/vladata-ja-usvoi-nacionalnata-strategija-za-mentalno-zdravje-na-mladi-2024-2026/>.

32 'Qeveria përcaktoi dhe miratoi tekstin për dokumentin më të madh strategjik për zhvillimin e Maqedonisë së Veriut në 20 vitet e ardhshme, Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit 2024-2044 (Vladata го утврди и усвои текстот за најголемиот стратешки документ за развојот на Северна Македонија во следните 20 години, Националната Развојna Strategija 2024- 2044), Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 27 shkurt 2024, <https://vlada.mk/node/36094>.

dhe integritetin e medias. Për më tepër, ligji i ndryshuar i jep Këshillit të Agjencisë së Medias autoritetin për të zgjatur automatikisht licencat për transmetuesit, me përjashtime për ata që shkelin në mënyrë të përsëritur dispozitat ligjore ose nuk raportojnë në mënyrë të drejtë gjatë një cikli zgjedhor.³³

Shoqëria civile

Gjatë periudhës raportuese, Këshilli për Bashkëpunim midis Qeverisë dhe Shoqërisë Civile mbeti joaktiv për shkak të bojkotit të vazhdueshëm të anëtarëve.³⁴ Disa zëra brenda shoqërisë civile bënë thirrje për llogaridhënie në lidhje me shqetësimet për ndryshimin e dokumenteve, duke theksuar të drejtat ligjore të qytetarëve për të ndjekur veprime ligjore kundër shtetit për shkelje të mundshme të lirisë së tyre të lëvizjes.³⁵

Mbikëqyrja Civile e Sektorit të Sigurisë/Inteligjencës

Në një panel diskutimi përpara konventës së kandidatëve presidencialë të VMRO-DPMNE-së më 2 mars, nën-kryetari i partisë bëri akuza kundër Agjencisë së Inteligjencës, duke e akuzuar atë për përgjim të paautorizuar të zyrtarëve të partisë dhe qarkullimin e raporteve të rreme. Agjencia e Inteligjencës i mohoi me shpejtësi këto akuza, duke pohuar angazhimin e saj ndaj procedurave standarde në lidhje me informacionin e klasifikuar. Për më tepër, Agjencia paralajmëroi kundër politizimit të emrit të saj për avantazh zgjedhor dhe nxiti kundër përhapjes së dezinformatave që mund të minojnë besimin e publikut në institucionet e sigurisë dhe inteligjencës.³⁶

33 'Maqedonia e Veriut i jep fund ndalimit të reklamave shtetërore në mediat private', Balkan Insight, 29 shkurt 2024, <https://balkaninsight.com/2024/02/29/north-macedonia-ends-ban-on-state-ads-in-private-media/>.

34 'Aleanca Evropiane për Ndryshim: Duhet të hetohet pse Grubi u dha para OJQ-ve të afërta me BDI-në (Evropски сојуз за промени: Да се испита зошто Груби доделил пари на невладини организации блиски до ДУИ)', Radio Evropa e Lirë, 28 janar 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32795351.html>.

35 'Avokatët tashmë po i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave - OJQ-të po bëjnë thirrje për padi kundër shtetit (Адвокати веќе се обраќаат до Уставен суд за заштита на слободите и правата - Невладини повикуваат на тужби против државата)', Telma, 14 shkurt 2024, <https://telma.com.mk/2024/02/14/advokati-veke-se-obrakaat-do-ustaven-sud-za-zashtita-na-slobodite-i-pravata-nevladini-povikuvaaat-na-tuzhbi-protiv-drzhavata/>.

36 'AI mohon pretendimet e Nikoloskit se përgjoi udhëheqësit e VMRO-DPMNE-së (AP ги негира тврдењата на Николоски дека го прислушувала раководството на ВМРО-ДПМНЕ)', 360 Stepeni, 5 mars 2024, <https://360stepeni.mk/ar-gi-negira-tvrdenata-na-nikoloski-deka-go-prisluhuvala-rakovodstvoto-na-vmro-dpmne/>.

Reforma e Administratës Publike

Në janar, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA) filloi bashkëpunim me shtatë universitete në administratën publike, TIK dhe media.³⁷ Pavarësisht spekulimeve të mediave rreth dorëheqjes të nxitura nga pengesat legjislative në lidhje me digjitalizimin dhe reformat e administratës publike,³⁸ Ministri nuk dha dorëheqjen, por ai përmendi bllokatat e ligjeve të koalicionit LSDM dhe BDI. Më pas, katër ligje u publikuan në faqen e internetit të Parlamentit,³⁹ duke përjashtuar Ligjin për Media.⁴⁰

Pas zgjedhjes së qeverisë tranzitore/teknike më 28 janar, Parlamenti emëroi zëvendësministra dhe zëvendësministra shtesë, duke përfshirë një zëvendësministër shtesë në MSHIA.⁴¹ Më pas, më 13 shkurt, u zgjodhën dy ministra të rinj, nga të cilët njëri mbikëqyr punën e MSHIA.⁴²

Në fund të shkurtit, Qeveria vlerësoi indeksin e cilësisë së institucioneve, duke përfshirë organe të ndryshme si MSHIA, Ministria e Shëndetësisë, e të tjera. MSHIA filloi një cikël të ri të “Metodologjisë për vlerësimin e indeksit të cilësisë së institucioneve”, në përputhje me Strategjinë RAP 2023–2030 dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë 2023–2025. Mbledhja e të dhënave u krye përmes pyetësorëve të shpërndarë në institucione. Drejtoria e të Ardhurave Publike demonstroi cilësinë më të lartë të punës. MSHIA planifikon ta zgjerojë këtë vlerësim çdo vit për të përfshirë institucione shtesë.⁴³

37 'MSHIA do të bashkëpunojë me shtatë universitete në fushat e administratës publike, TIK-ut dhe medias (МИОА ќе соработува со седум универзитети во областите јавна администрација, ИКТ и медиуми)', Kanal 5, 22 janar 2024, <https://kanal5.com.mk/mioa-kje-sorabotuva-so-sedum-univerziteti-vo-oblastite-javna-administracija-ikt-i-mediumi/a622091>.

38 'Ministri Azir Aliu gati të japë dorëheqjen? (Министерот Азир Алиу пред оставка?)', Nezavisen Vesnik, 23 janar 2024, <https://nezavisen.mk/ministerot-azir-aliu-pred-ostavka/>.

39 Ligjet për nëpunësit administrativë, punonjësit e sektorit publik, sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit, menaxhimin elektronik dhe shërbimet elektronike, dhe zhvillimin dhe trajnimin profesional të nëpunësve administrativë.

40 'Ministri Azir Aliu nuk jep dorëheqjen nga posti i tij (Министерот Азир Алиу не поднесува оставка од функцијата)', Kanal 5, 23 janar 2024, <https://kanal5.com.mk/ministerot-azir-aliu-ne-podnesuva-ostavka-od-funkcijata/a622336>.

41 'U zgjodhën edhe zëvendësministrat shtesë në qeverinë teknike (Избрани и дополнителните заменик-министри во техничката влада)', 360 Stepeni, 28 janar 2024, <https://360stepeni.mk/izbrani-i-dopolnitelnite-zamenik-ministri-vo-tehnickata-vlada/>.

42 'Parlamenti zgjodhi Ilir Demirin dhe Naim Bajramin si ministra të rinj të shëndetësisë dhe shoqërisë së informacionit dhe administratës (Собранието ги избра Илир Демири и Наим Бајрами за нови министри за здравство и информатичко општество и администрација)', Radio MoF, 13 shkurt 2024, <https://www.radio-mof.mk/sobranieto-gi-izbra-ilir-demiri-i-naim-bajrami-za-novi-ministri-za-zdravstvo-i-informaticko-opshtestvo-i-administracija/>.

43 'Shpallja e hulumtimit të kryer mbi indeksin e cilësisë së institucioneve (Соопштение за спроведено истражување за индекс на квалитет на институциите)', Faqja zyrtare e Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës, 5 mars 2024, <https://mioa.gov.mk/mk-MK/news/soopstение-za-sprovedeno-istrazu-vane-za-indeks-na-kvalitet-na-instituciite.nspх>.

Kapitulli 23



Funksionimi i Gjyqësorit

Dokumente strategjike

Për të mbikëqyrur në mënyrë efektive zbatimin e Strategjisë për Zhvillimin e Gjyqësorit për vitin 2024–2028 dhe për të siguruar respektimin e Planit të Veprimit, qeveria krijoi një këshill monitorimi më 26 mars 2024. Kryesuar nga Ministri i Drejtësisë, këshilli përfshin figura kyçe si Ministrat e Punëve të Brendshme, Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës dhe atë të Financave, Zëvendëskryeministrat për Çështjet Evropiane dhe Qeverisjen e Mirë, Prokurorin e Shtetit, Kryetarët e Gjykatës Supreme, Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë, si dhe përfaqësues nga akademia dhe organizatave të shoqërisë civile.⁴⁴

Organet menaxhuese

Pas shpalljes së zgjedhjeve të ardhshme presidenciale⁴⁵ dhe parlamentare⁴⁶ nga Parlamenti, Këshilli Gjyqësor ka vendosur të ndalojë përkohësisht proceset për zgjedhjen dhe vlerësimin e llogaridhënies së kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve, përveç në raste emergjente.⁴⁷ Kjo pauzë përputhet me Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, i cili kufizon fillimin e procedurave të reja të punësimit ose përfundimin e atyre ekzistuese brenda institucioneve shtetërore dhe publike gjatë periudhës zgjedhore, përveç rasteve urgjente.⁴⁸ Ky vendim ka nxitur diskutime nëse gjyqësori, si degë e pavarur e qeverisë, duhet t'i nënshtrohet këtyre kufizimeve. Ndryshe nga Këshilli Gjyqësor, Këshilli i Prokurorëve Publikë nuk ka miratuar një qasje të ngjashme.

Pasi Gjykata Administrative vendosi shkarkimin e paligjshëm të kryetares të mëparshme të Këshillit Gjyqësor, individit rifillio pozitën më 3 janar 2024, duke zhvendosur kryetarin e emëruar në mënyrë të parregullt.⁴⁹ Në përgjigje të shqetësimeve të publikut në lidhje me ligjshmërinë e veprimeve të ndërmarra gjatë mandatit të kryetarit të emëruar në mënyrë të parregullt, Këshilli Gjyqësor pohoi se këto veprime mbeten ligjërish të vlefshme.⁵⁰ Megjithatë, ky pohim kundërshtohet nga sektori civil dhe akademia, të cilët kundërshtojnë ligjshmërinë e vendimeve të marra gjatë asaj periudhe.⁵¹ Ndërkohë, misionet diplomatike⁵² dhe palët e tjera të interesit⁵³ mirëpritën vendimin e gjykatës, duke çuar në rifillimin e projekteve të ndërprera më parë.⁵⁴

44 'Qeveria, në seancën e sotme, mori vendim për krijimin e Këshillit për monitorimin e zbatimit të Strategjisë Sektoriale të Zhvillimit të Gjyqësorit (2024-2028)', Faqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 26 mars 2024, <https://www.pravda.gov.mk/vest/6691>.

45 'Dorëzimi i Vendimit për shpalljen e zgjedhjeve për Presidentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (Достава на Решение за распишување избори за претседател на Република Северна Македонија)', 14 shkurt 2024, <https://drive.google.com/file/d/1LgvXvn7-cx3IWbxLchlxEZY0cjiYKqYv/view>.

46 'Dorëzimi i Vendimit për shpalljen e zgjedhjeve për deputetë në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (Достава на Решение за распишување избори за пратеници во Собранието на Република Северна Македонија)', 14 shkurt 2024, <https://drive.google.com/file/d/1XP6jrSKDr-BVIDuMAwCJqBGak88qbx2g/view>.

47 'Njoftim nga seanca e 481-të e Këshillit Gjyqësor të RMV-13.03.2024 dhe vazhdimi më 20.03.2024 (Соопштение од 481-та седница на Судскиот совет на РСМ - 13.03.2024 и продолжение на 20.03.2024 година), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3QgOd0e>.

48 'Kodi Zgjedhor - tekst i konsoliduar (Изборниот законик - консолидиран tekst)', Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë/Maqedonia e Veriut Nr. 04/06, 87/2006, 127/06, 136/08, 155/08, 163/08, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 31/15, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 142/16, 57/17, 67/17, 125/17, 35/18, 99/18, 140/18, 208/18, 27/19, 98/19, 82/2017, 146/19, 42/20, 74/21, 215/21, 58/24.

49 'Njoftim nga seanca URGJENTE e 471-të e Këshillit Gjyqësor të RMV-03.01.2024 (Соопштение од 471-та ИТНА седница на Судскиот совет на РСМ - 03.01.2024 година), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/4aLlYz2>.

50 'Njoftim (Соопштение)', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 5 janar 2024, <https://bit.ly/3wE9jH>.

51 'Koalicioni "Të gjithë për gjykime të drejta": Të gjitha vendimet e Këshillit Gjyqësor nga maji 2023 deri dje janë të pavlefshme (Коалиција „Сите за правично судење“: Сите одлуки на Судскиот совет од maj 2023 година до вчера се ништовни)', TV 24, 4 janar 2024, <https://24.mk/details/koalicija-site-za-pravichno-sudenje-site-odluki-na-sudskiot-sovet-od-maj-2023-godina-do-vchera-se-nishtovni>.

52 'Ambasadori Gir dhe Kryetarja Dameva ranë dakord për rëndësinë e pavarësisë në punën e Këshillit Gjyqësor (Ambasadorot Gir и претседателката Дамева се согласија за важноста на независноста во работењето на Судскиот совет)', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 16 janar 2024, <https://bit.ly/3vUrYX7>; 'Takimi i Ambasadores Amerikane Ageler me kryetaren Dameva (Средба на американската амбасадорка Агелер со претседателката Дамева)', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 26 janar 2024, <https://bit.ly/4b1fTOS>; 'Kryetarja Vesna Dameva kishtenjë vizitëpune me Shefin e Misionit të OSBE-së në Shkup, Ambasadorin Kilian Vall (Претседателката Весна Дамева оствари работна посета со шефот на Мисијата на ОБСЕ во Скопје, амбасадорот Килијан Вал)', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 27 shkurt 2024, <https://bit.ly/4d145h4>.

53 'Takim Dameva-Lloga (Средба Дамева-Ллога)', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 18 janar 2024, <https://bit.ly/3QcVL49>; 'Grupi Bluprint për Reforma në Gjyqësor mbështet vendimin e Gjykatës Administrative për t'a bërë të pavlefshëm vendimin për shkarkimin e Kryetares të atëhershme të Këshillit Gjyqësor të RMV (Блупринт групата за реформи во правосудството ја поздравува одлуката на Управниот суд за поништување на одлуката за разрешување од функција на тогашната претседателка на Судски совет на РСМ)', Faqja zyrtare e Grupit Bluprint për Reforma në Gjyqësor, 16 janar 2024, <https://bit.ly/49PHATs>.

54 'Takimi i kryetares Dameva me Ambasadorin Kop për rinovimin e projektit MATRA (Средба на претседателката Дамева со амбасадорот Коп за обновување на проектот MATRA)', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 6 shkurt 2024, <https://bit.ly/3jxkUIU>.

Pas rekomandimeve nga misioni vlerësues i kolegëve të Bashkimit Evropian, Këshilli Gjyqësor miratoi një Plan Veprimi më 29 shkurt 2024.⁵⁵ Ky plan përfshin afate kohore të detajuara për përfundimin e detyrave në përputhje me sugjerimet e BE-së. Iniciativa e parë në kuadër të këtij plani ishte fillimi i zhvillimit të Strategjisë së Komunikimit për Këshillin Gjyqësor dhe për Gjykatat e Republikës së Maqedonisë së Veriut për 2024–2028. E nisur në mars me mbështetjen e projektit të BE-së për sundimin e ligjit, strategjia është hartuar për të përmirësuar aftësitë e komunikimit dhe marrëdhëniet me median si të Këshillit ashtu edhe të gjykatave.⁵⁶

Gjatë periudhës raportuese, një anëtar i Këshillit Gjyqësor nga zona e apelit në Manastir doli në pension pasi plotësoi kushtet e kërkuara.⁵⁷ Më pas, u formua një komision për të trajtuar këtë vend vakant dhe një vend vakant midis gjyqtarëve të Gjykatës Supreme⁵⁸ Pas dy përpjekjeve të pasuksesshme, komisioni u krijua pas një thirrjeje të tretë për pozicionin e fundit.⁵⁹ Gjithashtu, Këshilli i Prokurorëve Publikë pa pensionimin e dy anëtarëve.⁶⁰ Këto vende vakante u plotësuan duke zgjedhur anëtarë të rinj nga Prokuroria e Lartë Publike (mandati zgjedhor 3)⁶¹ dhe Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut (mandati zgjedhor 5).⁶²

Pavarësia dhe paanshmëria

Më 24 janar 2024, u krijua Këshilli i ri për Koordinimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në Organet Gjyqësore (Këshilli i TIK). Ky këshill prej 13 anëtarësh përfshin, për herë të parë, një përfaqësues nga sektori i shoqërisë civile, nga grupi Blueprint për reformat gjyqësore dhe një përfaqësues nga Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë. Anëtarët e këshillit emërohen për një mandat dyvjeçar.⁶³

Këshilli Gjyqësor ka njoftuar fillimin e një procedure të prokurimit publik për të pajisur seancat e tij me mundësi regjistrimi audio dhe video dhe transmetimi të drejtpërdrejtë për të rritur transparencën. Deri në përfundimin e këtij procesi, të gjitha mediat janë të ftuara të ndjekin dhe transmetojnë seancat lirshëm drejtpërdrejtë pa kompensim. Kjo masë e përkohshme pasqyron angazhimin e Këshillit për angazhim jo-selektiv dhe qasje të barabartë për të gjitha mediat, duke theksuar se nuk ekzistojnë partineritete ekskluzive për mediat.⁶⁴

55 'Njoftim nga seanca e 480-të e Këshillit Gjyqësor të RMV -29.02.2024 (Соопштение од 480-та седница на Судскиот совет на РСМ - 29.02.2024 година)', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3UcMlqy>.

56 'Punëtorja për zhvillimin e Strategjisë së Komunikimit të Këshillit Gjyqësor dhe Gjykatave të Republikës së Maqedonisë së Veriut (2024-2028) (Работилница за изработка на Комуникациска стратегија на Судскиот совет и судовите на Република Северна Македонија (2024-2028))', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 19 mars 2024, <https://bit.ly/3vXJqdj>.

57 'Njoftim nga seanca e 476-të e Këshillit Gjyqësor të RMV-31.01.2024 (Соопштение од 476-та седница на Судскиот совет на РСМ - 31.01.2024 година)', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3Uy5tk6>.

58 'Njoftim nga seanca e 477-të e Këshillit Gjyqësor të RMV-12.02.2024 (Соопштение од 477-та седница на Судскиот совет на РСМ - 12.02.2024 година)', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3WeuMZV>.

59 'Shpallje për zgjedhjen e 1 (një) anëtari nga rradhët e gjyqtarëve nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe për zgjedhjen e 1 (një) anëtari nga rradhët e gjyqtarëve nga Zona e Apelit të Manastirit (Оргас за избор на 1 (еден)).

60 'Vendimi për ndërprerjen e detyrës së anëtares Fidanka Rajevska (Одлука за престанок на функција на член-Фиданка Рајеvsка)', Faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 13 shkurt 2024, <https://bit.ly/3xOMUik>; 'Procesverbali i seancës të 100-të të KPPRMV (Записник од 100 седница на СЈОРСМ)', Faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 28 mars 2024, <https://bit.ly/3QfVhko>.

61 'Njoftim (Соопштение)', Faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 26 janar 2024, <https://bit.ly/44d4QzK>.

62 'Shpallja e rezultateve përfundimtare nga zgjedhjet për anëtar të KPPRMV (Соопштение за конечни резултати од спроведени изборi за член на СЈОРСМ)', Faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 22 mars 2024, <https://bit.ly/3Uxgh21>.

63 'Përbërja e re për Këshillin e TIK në Gjyqësor është formuar (Формиран новиот состав за Советот на ИКТ во правосудството)', Faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 25 janar 2024, <https://www.pravda.gov.mk/vest/6654>.

64 'Njoftim (Соопштение)', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 13 mars 2024, <https://bit.ly/3w6GtqS>.

Llogaridhënia

Më 17 janar 2024, Këshilli Gjyqësor, me një votim shtatë me katër, vendosi terminimin e procedimit disiplinor ndaj Kryetarit të Gjykatës së Lartë që ishte iniciuar nga një anëtar i këshillit.⁶⁵

Profesionalizmi dhe kompetenca

Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë kanë përcaktuar numrin e vendeve vakante për gjyqtarë dhe prokurorë publikë për gjeneratën e dhjetë të Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë (AGJPP). Ata kanë përcaktuar 162 pozicione gjyqësore⁶⁶ dhe 30 pozicione të prokurorit publik.⁶⁷ Kjo ndarje u bazua në analizat e mëparshme dhe datat e parashikuara të pensionimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë tre viteve të ardhshme. Këto vendime janë dorëzuar zyrtarisht në AGJPP.⁶⁸

Gjatë periudhës raportuese, Këshilli Gjyqësor caktoi një gjyqtarë nga Gjykata e Apelit të Gostivarit dhe dy gjyqtarë të Gjykatës së Apelit të Shtipit⁶⁹ të caktuar përkatësisht për çështje penale dhe civile.⁷⁰ Përveç kësaj, nëntë juristë u zgjedhën për Gjykatën Themelore të Vinicës⁷¹, me katër të tjerë të emëruar në Gjykatën Themelore Penale të Shkupit dhe Gjykatën Themelore të Gjevgjelisë.⁷²

Njëkohësisht, Këshilli i Prokurorëve Publikë emëroi dy prokurorë publikë në Prokurorinë e Lartë Publike Shkup.⁷³ Për më tepër, ai lëshoi thirrje për aplikime për dy pozicione të tjera të prokurorit publik në të njëjtën zyrë, si dhe dy pozicione në Zyrën e Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit.⁷⁴

Pasi Këshilli i Prokurorëve Publikë refuzoi kërkesën për rishqyrtim të vendimit për refuzimin e dokumentacionit në lidhje me shpalljen për emërimin e prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga kandidati i Prokurorisë së Lartë Publike,⁷⁵ Parlamenti vazhdoi me zgjedhjen e kandidatit të vetëm të emëruar më 13 shkurt 2024.⁷⁶

65 'Njoftim nga seanca e 473-të e Këshillit Gjyqësor të RMV-17.01.2024 (Соопштение од 473-та седница на Судски совет на РСМ - 17.01.2024 година)', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/4ban4nB>.

66 'Njoftim nga seanca e 482-të e Këshillit Gjyqësor të RMV-27.03.2024 (Соопштение од 482-та седница на Судскиот совет на РСМ - 27.03.2024 година)', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/4b2ynyi>.

67 'Procesverbal i seancës të 97-të të KPPRMV (Записник од 97 седница на СЈОРСМ)', Faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 28 shkurt 2024, <https://bit.ly/3UhnKAR>.

68 'Njoftim nga seanca e 482-të e Këshillit Gjyqësor të RMV-27.03.2024 (Соопштение од 482-та седница на Судскиот совет на РСМ - 27.03.2024 година);' Procesverbal i seancës të 97-të të KPPRMV (Записник од 97 седница на СЈОРСМ) '.

69 'Njoftim nga seanca e 477-të e Këshillit Gjyqësor të RMV-12.02.2024 (Соопштение од 477-та седница на Судскиот совет на РСМ - 12.02.2024 година)'.
70 'Njoftim nga seanca urgjente e 478-të e Këshillit Gjyqësor të RMV 02/13/2024 (Соопштение од 478-та итна седница на Судскиот совет на РСМ 13.02.2024 година), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3QnkXF5>.

71 'Njoftim nga seanca e 473-të e Këshillit Gjyqësor të RMV-17.01.2024 (Соопштение од 473-та седница на Судски совет на РСМ - 17.01.2024 година)'.
72 'Njoftim nga seanca e 480-të e Këshillit Gjyqësor të RMV-29.02.2024 (Соопштение од 480-та седница на Судскиот совет на РСМ - 29.02.2024 година)'.
73 'Vendimi për përzgjedhjen e prokurorëve publikë në Prokurorinë e Lartë Publike Shkup (Одлука за избор на јавни обвинители во Вишото јавно обвинителство Скопје)', Faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 13 shkurt 2024, <https://bit.ly/3waFtlw>.

74 'Njoftim për përzgjedhjen e prokurorëve publikë (Орнас за избор на јавни обвинители)' (Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut), 13 shkurt 2024, <https://bit.ly/4ddDmhh>.

75 'Këshilli i Prokurorëve Publikë njëzëri refuzoi kërkesën e Fatime Fetai për të shqyrtuar vendimin për refuzimin e kandidatit të saj për prokuror publik shtetëror (Советот на јавни обвинители едногласно го отфрли барањето на Фатиме Фетаи за преиспитување на одлуката за отфрлање на нејзината кандидатура за државен јавен обвинител)', A1 On 11 janar 2024, <https://a1on.mk/macedonia/sovetot-na-jo-ednoglasno-go-otfrli-baranjeto-na-fatime-fetai-za-preispituvanje-na-odlukata-za-otfrlanje-na-nejzinata-kandidatura-za-drzhaven-javen-obvinitel/>.

76 'Љупчо Коцевски është prokurori i ri publik shtetëror (Љупчо Коцевски е нов државен јавен обвинител)', Makfax News Agency, 13 shkurt 2024, <https://bit.ly/3UAVOZW>.

Cilësia e Drejtësisë

Për shkak të procesit të gjatë të prokurimit publik për mirëmbajtjen e softuerit të përdorur në administrimin e provimeve brenda institucioneve shtetërore nga Ministria e Shoqërisë së Informacionit dhe Administratës, së bashku me një direktivë të Qeverisë që detyron institucionet të kryejnë provime elektronike në letër me një lexues elektronik, AGJPP ka zbatuar disa masa për të lehtësuar një tranzicion pa probleme.⁷⁷ Këto masa përfshijnë propozimin e ndryshimeve në Ligjin për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, përditësimin e Statutit të Akademisë dhe miratimin e një Rregulloreje të re për rishikimin e rregullave të provimit pranues, duke i përafuar ato me legjislacionin e ndryshuar.⁷⁸ Më pas, Bordi Drejtues udhëzoi Komisionin e Pranimit të hartojë një orar të ri për fazat e ardhshme të provimit pranues, me shpalljen e datës së re të testit të kualifikimit sapo të jetë finalizuar.⁷⁹

Miratimi i orarit të ri çoi në një ankesë nga VMRO–DPMNE në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), duke pretenduar shkelje të Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, të cilat ndalojnë procedurat e reja të punësimit dhe shkarkime në institucionet publike dhe shtetërore nga shpallja e zgjedhjeve, duke mandatuar pezullimin e procedurave në vazhdim.⁸⁰

Në përgjigje, AGJPP përmendi një rast të ngjashëm gjatë zgjedhjeve të vitit 2017 që përfshinin pranimin e gjeneratës të VI të kandidatëve, ku u përcaktua se nuk kishte shkelje pasi çështjet konsideroheshin urgjente. Ky vendim u validua më tej nga Inspektorati Shtetëror i Punës pas një inspektimi të posaçëm. Përveç kësaj, AGJPP theksoi se pranimi i një brezi të ri është një proces kompleks që merr mbi një vit dhe sipas orarit të ri, kontrata më e hershme e punës me Akademinë do të përfundonte në shtator të vitit 2024, duke treguar respektimin e standardeve ligjore.⁸¹

Efikasiteti

Më 8 shkurt 2024, pas tërheqjes së nominimit të ish-Prokurorit Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut si gjyqtar i ri kushtetues,⁸² partia në pushtet propozoi një kandidat të ri i cili më pas u zgjodh.⁸³ Me këtë emërim u plotësua vendi i fundit vakant, duke plotësuar përbërjen e Gjykatës Kushtetuese.

Në 28 shkurt 2024, Gjykata Kushtetuese vendosi të shfuqizojë kërkesën ligjore për të deklaruar kombësinë në certifikatat e lindjes, martesës dhe vdekjes, duke hequr efektivisht kolonën “kombësi” nga Ligjimi për Gjendjen Civile. Gjykata konkludoi se mandati i këtij informacioni bie në kundërshtim me parimin kushtetues të shprehjes së lirë të kombësisë. Artikulli kushtetues përkatës jo vetëm që lejon individët të deklarojnë kombësinë e tyre lirshëm, por gjithashtu jep të drejtën për të mos treguar ose ndryshuar këtë deklaratë - një fleksibilitet që dispozitat e shfuqizuara nuk e akomoduan.⁸⁴

77 'Njoftim nga Komisioni i Pranimit për kursin e provimit të pranimit dhe për orarin e ri të përcaktuar për pjesën e mëtejshme të provimit të pranimit (Известување од Приемната комисија за текот на Приемниот испит и за утврдена нова временска динамика за понатамошниот дел од Приемниот испит)', Faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë "Pavel Shatev", 18 mars 2024, <https://bit.ly/3UdGkd3>.

78 Ibid.

79 'Orari për marrjen e testit kualifikues (Распоред за полагање на квалификацијониот тест)', Faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë "Pavel Shatev", 29 mars 2024, <https://bit.ly/4d8cjUR>.

80 'VMRO–DPMNE dorëzoi një ankesë në KSHPK kundër Akademisë për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publik për shkelje të Kodit Zgjedhor (ВМРО–ДПМНЕ поднесе пријава до ДКСК против Академијата за судии и јавни обвинители за прекршување на Изборниот законик)', A1 On, 21 Mars 2024, <https://a1on.mk/macedonia/vmro-dpmne-podnese-prijava-do-dksk-protiv-akademijata-za-sudii-i-javni-obviniteli-za-prekrshuvanje-na-izborniot-zakonik/>.

81 'Njoftim në lidhje me ankesën e dorëzuar kundër AGJPP "Pavel Shatev" në KSHPK për shkelje të Kodit Zgjedhor (Соопштение во врска со поднесена пријава против Академијата за судии и јавни обвинители „Павел Шатев“ до Државната Комисија за спречување на корупција за прекршување на Изборниот законик)', Faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarët dhe Prokurorët Publikë "Pavel Shatev", 21 mars 2024, <https://bit.ly/3w7SP1Y>.

82 'Propozimi për të emëruar Ljubomir Joveskin si gjyqtar kushtetues u tërhoq (Повлечен предлогот Љубомир Јовески да биде избран за уставен судија)', 360 Stepeni, 24 janar 2024, <https://360stepeni.mk/joveski-iznenaduvachki-i-vulgarno-e-toa-shto-predlogot-za-ustaven-sudija-e-povlechen-bez-da-se-navedat-osnovnite-prichini/>.

83 'Ana Pavlovska-Daneva u emërua si gjyqtare kushtetuese - kompletetohet përbërja e Gjykatës Kushtetuese ((Ана Павловска-Данева избрана за уставен судија-комплетиран е составот на Уставниот суд)', Telma TV, 8 shkurt 2024, <https://telma.com.mk/2024/02/08/ana-pavlovska-daneva-izbrana-za-ustaven-sudija-kompletiran-e-sostavot-na-ustavniot-sud/>.

84 'Kolona e "kombësisë" në tre nene në Ligjin për Gjendjen Civile është hequr (Укинат делот „националност“ во три члена од Законот за матична евиденција)', Faqja zyrtare e Gjykatës Kushtetuese të Republikës të Maqedonisë së Veriut, 28 shkurt 2024, <https://ustavensud.mk/?p=25759>.

Më 29 shkurt 2024, Parlamenti miratoi ndryshimet për gjashtë ligje, duke rregulluar koeficientët e pagave për rreth 1.060 zyrtarë të zgjedhur dhe të emëruar duke përfshirë presidentin, deputetët, ministrat, gjyqtarët dhe prokurorët publikë.⁸⁵ Këto ndryshime ndalojnë çdo rritje të mëtejshme të pagave duke ruajtur rritjen prej 78 për qind të vitit të mëparshëm.⁸⁶ Ndryshimet u ndeshën me kundërshtimin e Këshillit Gjyqësor,⁸⁷ Këshillit të Prokurorëve Publikë,⁸⁸ Shoqatës të Gjyqtarëve⁸⁹ dhe Shoqatës të Prokurorëve Publikë⁹⁰, të cilët argumentojnë se ndryshimet kompromentojnë pavarësinë financiare të gjyqësorit, duke ndikuar negativisht në vendim-marrjen, praktikën e punësimit dhe pagesën e shtesave të pagave. Si pasojë, ata kanë paraqitur iniciativë në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e këtyre ndryshimeve, veçanërisht ato që prekin ligjet e pagave për gjyqtarët, anëtarët e Këshillit Gjyqësor, anëtarët e Këshillit të Prokurorëve Publikë dhe prokurorët publikë.⁹¹ Më pas, më 19 mars 2024, Qeveria miratoi edhe një reduktim të koeficientëve të pagave për zyrtarët që emëron, duke siguruar përputhjen me Ligjin për pagën dhe kompensimin tjetër për zyrtarët e zgjedhur dhe të emëruar.⁹²

85 'U miratua Paketa e Ligjeve mbi Pagat e Personave të Zgjedhur dhe të Emëruar (Изгласани пакетот закони за платите на избраните и именуваните лица)', *Biznisvesti.Mk*, 29 shkurt 2024, <https://biznisvesti.mk/izglasani-paketot-zakoni-za-platite-na-izbranite-i-imenuvanite-litsa/>.

86 Ibid.

87 'Njoftim (Соопштение)', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 28 shkurt 2024, <https://bit.ly/49UBjvX>.

88 'Njoftim (Соопштение)', Faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 19 mars 2024, <https://bit.ly/3UxdpCg>.

89 'Njoftim për publikun lidhur me propozimin për Ligjin për ndryshimet në Ligjin për pagat e gjyqtarëve në një procedurë të shkurtuar (Соопштение на јавноста во врска со Предлог на Законот за изменување на Законот за платите на судиите по скратена постапка)', Faqja zyrtare e Shoqatës së Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 28 shkurt 2024, <https://bit.ly/49WdCU2>.

90 'Shoqata e Prokurorëve Publikë reagon ndaj ndryshimeve të njoftuara në ligjin për pagat (Здружението на јавни обвинители реагира по најавените законски измени за платите)', *A1 On*, 28 shkurt 2024, <https://a1on.mk/macedonia/zdruzeniето-na-javni-obviniteli-reagira-po-na-javenite-zakonski-izmeni-za-platite/>.

91 'Njoftim (Соопштение)', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 6 mars 2024, <https://bit.ly/4bcPltE>; 'Iniciativa për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë (Иницијатива за оценување на уставноста и законитоста)', Faqja zyrtare e Shoqatës së Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 7 mars 2024, <https://bit.ly/4d8Ghbn>.

92 'Nga sesioni i 11-të i Qeverisë: Vendim për uljen e koeficientëve të pagave të zyrtarëve të emëruar nga qeveria; Përfundim në drejtim të realizimit të së drejtës së votës të qytetarëve me dokumente personale të skaduara (Од 11. владина седница: Одлука за намалување на коефициентите на платите на функционерите кои ги именува Владата; Заклучок во насока на реализација на правото на глас на граѓани со истечени лични документи)', Faqja zyrtare e Qeverisë të Republikës të Maqedonisë së Veriut, 19 mars 2024, <https://vlada.mk/node/36224>.

Lufta Kundër Korrupsionit

Indeksi më i fundit i perceptimit të korrupsionit nga Transparency International e renditi Maqedoninë e Veriut në vendin e 76-të në botë me 42 pikë treguese, krahasuar me vendin e 85-të vitin e kaluar me 40 pikë treguese. Një renditje e tillë tregon përparim pavarësisht zhvillimeve shqetësuese⁹³ që u zbuluan gjatë vitit të kaluar.⁹⁴

Sipas Vlerësimit të Sistemit Kombëtar të Integritetit 2023, të përgatitur dhe botuar nga Transparency International Macedonia, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), së bashku me Entin Shtetëror të Revizionit dhe Avokatin e Popullit, ka rezultatet më të mira për integritetin, llogaridhënien, përgjegjësinë dhe gatishmërinë për të luftuar korrupsionin.⁹⁵ KSHPK-ja është një nga shtyllat që përbën këtë sistem integriteti dhe është përcaktuar si e dyta në listën e 15 shtyllave. Në të njëjtën kohë, Prokuroria Publike (PP) është shtylla me rankun më të ulët.⁹⁶

Në shtojcën e dytë të Raportit të Dytë për Maqedoninë e Veriut, Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) vlerësoi se nga 19 rekomandime në lidhje me parandalimin e korrupsionit midis deputetëve, gjyqtarëve, dhe prokurorëve, 14 janë zbatuar në një masë të kënaqshme, katër rekomandime janë zbatuar pjesërisht, dhe vetëm një rekomandim nuk është zbatuar nga vendi.⁹⁷

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit

Nga fundi i mandatit të përbërjes aktuale të KSHPK-së, ata raportuan hapjen e 5,283 lëndëve gjatë mandatit të tyre, duke përfshirë 2,872 për korrupsion, 888 për konflikte interesi, 144 për ndalime të procesit zgjedhor dhe 1,379 për inspektime të statusit të pronës. Janë lëshuar 898 urdhërpagesa për shkelje të ligjit, duke arkëtuar rreth 8 milionë euro në gjoba për buxhetin e shtetit.⁹⁸ Megjithatë, pavarësisht fillimit të 56 procedimeve penale, asnjë padi nuk u ngrit për shkak të mosveprimit nga institucionet e tjera.⁹⁹ Ata përfunduan mandatin e tyre duke u takuar me përfaqësuesit e OSHC-ve për të diskutuar arritjet e tyre dhe sfidat me të cilat u përballën gjatë punës së tyre.¹⁰⁰

KSHPK-ja e re, e përbërë nga katër auditorë, dy punonjës të KSHPK-së dhe një gjyqtar,¹⁰¹ filloi më 8 shkurt. Ata filluan punën e tyre duke diskutuar aktivitetet dhe sfidat e vazhdueshme me anëtarët e mëparshëm,¹⁰²

93 Ngjarje të tilla përfshijnë ndryshimet e miratuara në mënyrë jodemokratike në Kodin Penal, të cilat zvogëlojnë dënimet për shpërdorim të detyrës për përfitime personale dhe afate të shkurtuara për fillimin e procedimeve për rast të dyshuar të korrupsionit, si dhe emërimet dhe shkarkimet e motivuara politikisht të zyrtarëve gjyqësorë.

94 'IPK 2023 për Evropën Lindore dhe Azinë Qendrore: Autokracia dhe sistemet e dobëta të drejtësisë mundësojnë korrupsion të përhapur (ИПК 2023 за Источна Европа и Централна Азија: Автократијата и слабите правосудни системи овозможуваат широко распространета корупција)', Uebfaqja zyrtare e Transparency International - Macedonia (blog), 30 janar 2024, <https://transparency.mk/2024/01/30/ipk-2023-za-istochna-evropa-i-centralna-azi-%d1%98ata-i-slabite-pravosudni-sistemi-ovozmozhuvaat-shiroko-rasprostraneta-korupczi-%d1%98a/>.

95 Slagjana Taseva et al., 'Vlerësimi i Sistemit Kombëtar të Integritetit 2023 (Процена на Националниот систем за интегритет 2023)' (Transparency International Macedonia, 17 nëntor 2023), <https://transparency.mk/wp-content/uploads/2024/01/national.integrity.system.assessment.2023-4.pdf>.

96 'Enti Shtetëror i Revizionit, Antikorrupsioni dhe Avokati i Popullit kanë rezultatet më të mira për integritet, më e dobëta është Prokuroria, gjykatat dhe shërbimet e zbatimit të ligjit (Ревизија, Антикорупциска и Омбудсман со најдобри резултати за интегритет, најслаби обвинителството, судовите и службите за спроведување на законите)', Nova TV, 12 janar 2024, <https://novatv.mk/revizija-antikorupciska-i-ombudsman-so-najdobri-rezultati-za-integritet-najslabi-obvinitelstvoto-sudovite-i-sluzhbite-za-sproveduvane-na-zakonite/>.

97 'GRECO ende pret që autoritetet maqedonase të shfuqizojnë pozicionin e Ministrit të Drejtësisë në Këshillin Gjyqësor (ГРЕКО сè уште чека македонските власти да ја укинат функцијата на министерот за правда во Судскиот совет)', 360 Stepeni, 12 mars 2024, <https://360stepeni.mk/greko-se-ushte-cheka-makedonskite-vlasti-da-ja-ukinat-funkcijata-na-ministerot-za-pravda-vo-sudskiot-sovet/>.

98 'Pesë vjet të mandatit të KSHPK-së: Procedurat gjyqësore kundër zyrtarëve janë një trashëgimi për antikorrupsionistët e ardhshëm (Пет години мандат На ДКСК: Судските разрешници против функционерите аманет за идните антикорупционери)', Sloboden Pecat, 31 janar 2024, [https://www.slobodenpecat-mk-pet-godini-mandat-na-dskk-sudskite-razreshnici-protiv-funkcionerite-amanet-na-antikorupcionerite/](https://www.slobodenpecat.mk/www-slobodenpecat-mk-pet-godini-mandat-na-dskk-sudskite-razreshnici-protiv-funkcionerite-amanet-na-antikorupcionerite/).

99 'Në pesë vjet nuk ka pasur epilog nga ndonjë iniciativë antikorrupsion (За пет години нема епилот од ниту една иницијатива на Антикорупциската)', Radio MOF, 1 shkurt 2024, <https://www.radiomof.mk/za-pet-godini-nema-epilog-od-nitu-edna-inicijativa-na-antikorupciskata/>.

100 'Takim me përfaqësuesit e organizatave joqeveritare (Средба со претставниците на невладините организации)', Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (blog), 2 shkurt 2024, <https://bit.ly/3PVu04E>.

101 'Auditorë, nëpunës civilë dhe një gjyqtar - anëtarët e përbërjes së re të Komisionit Kundër Korrupsionit janë përcaktuar (Ревизори, службеници и судија - утврдување членовите на новиот состав на Антикорупциска комисија)', Radio MOF, 29 nëntor 2023, <https://www.radiomof.mk/revizori-sluzhbenici-i-sudijka-utvrdeni-chlenovite-na-noviot-sostav-na-antikorupciska-komisija/?fbclid=IwAR2dKaTrpoBFuaXyE6OtzQCF2pbQtsUyxOV0Gd7aE4Ent5LfnFpSI-qY0ZI>.

102 'Ka filluar mandati i përbërjes së re të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (Започна мандатот на новиот состав на Државната комисија за спречување на корупцијата)', Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (blog), 8 shkurt 2024, <https://bit.ly/43RYxk0>.

mbajtën seancën e tyre të parë,¹⁰³ dhe shpallën masa për zgjedhje të ndershme, të tilla si monitorimi dhe raportimi i paligjshmërive.¹⁰⁴ Ata gjithashtu zhvilluan takime të shumta me Prokurorin Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut,¹⁰⁵ shoqërinë civile,¹⁰⁶ dhe Misionin e ardhshëm Vëzhgues për Zgjedhjet (MVZ) të Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR),¹⁰⁷ me qëllim luftimin e korrupsionit dhe parregullsive zgjedhore.¹⁰⁸

Përveç kësaj, ata filluan një sistem të ri elektronik për deklaratat e pasurive përmes <https://imotnasostojba.dksk.mk/>¹⁰⁹. Ata ftuan të gjithë personat aktualë të zgjedhur dhe të emëruar të cilët ishin të detyruar të paraqisnin deklarata interesi për ta bërë këtë në formularin e ri.¹¹⁰

KSHPK gjithashtu nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Drejtorinë e Policisë Financiare për të çuar përpara bashkëpunimin e ndërsjellë përmes komunikimit në kohë, të menjëhershëm dhe të ndërsjellë. Kjo do të sigurojë shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit thelbësor dhe përgatitjen e projekteve të përbashkëta për avancimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.¹¹¹

Prokuroria Publike

Në fillim të vitit, Ofruesi i Shërbimeve të Navigacionit Ajror i Maqedonisë M-NAV, në Aeroportin Ndërkombëtar të Shkupit u përball me trazira. Punësimi pa asnjë shpallje konkursi, favorizimi i lidhjeve politike dhe një grevë e mëvonshme e udhëhequr nga kontrollorët e trafikut ajror. Ndërhyrja politike u përshkallëzua dhe ndodhi një incident i shkeljes së barrierave të sigurisë dhe një sulm ndaj kontrollorëve,¹¹² duke shkaktuar kërcënime për një grevë pa fluturim.¹¹³ Qeveria ndërmori veprime urgjente, duke përfshirë shkarkimin e drejtorëve të M-NAV.¹¹⁴ Kryeministri deklaroi se M-NAV ishte bërë një kompani familjare, duke renditur shembuj të nepotizmit dhe kronizmit¹¹⁵ dhe kështu, deklaroi se Eurocontrol dhe institucionet shtetërore vendase duhet t'i trajtojnë këto çështje më seriozisht,¹¹⁶ dhe në të njëjtën kohë, ai njoftoi një inspektim

103 'Seanca e parë (konstitutive) e KSHPK-së (Прва конститутивна)', Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (blog), 15 shkurt 2024, <https://bit.ly/4cONhdc>.

104 'Lajmërim (Известување)', Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (blog), 16 shkurt 2024, <https://bit.ly/43Rz5BO>.

105 'Takim me Prokurorin Publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Средба со Јавниот обвинител на Република Северна Македонија)', Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (blog), 13 mars 2024, <https://bit.ly/49uBv4W>.

106 'Takimi me përfaqësues të organizatave të sektorit të shoqërisë civile anëtarë të Platformës për Luftën kundër Korrupsionit (Средба со претставници на граѓанскиот сектор – членки на Платформата за борба против корупцијата)', Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (blog), 13 mars 2024, <https://bit.ly/49rntkh>.

107 'Takimi me Xhilian Stirk, Shef i Misionit të ardhshëm Vëzhgues për Zgjedhjet (MVZ) të Zyrës së OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) (Средба со Џилиан Стирк, шеф на Мисијата за набљудување на престојните избори (ЕОМ))', Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (blog), 28 mars 2024, <https://bit.ly/4d266tA>.

108 'Takim pune me Prokurorinë Publike në lidhje me aktivitetet për monitorimin e procesit zgjedhor (Работна средба со Јавното обвинителство во врска со активностите за следење на изборниот процес)', Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (blog), 21 mars 2024, <https://bit.ly/3vSL8fK>.

109 'Nga data 01.01.2024 do të vihet në funksion sistemi i ri elektronik për dorëzimin e deklaratës së gjendjes pasurisë dhe interesave. (Од 01.01.2024 ќе биде во функција новиот електронски систем за поднесување на изјава за имотна состојба и интереси)', Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 28 dhjetor 2023, <https://bit.ly/3O727RL>.

110 'Thirrje publike (Јавен повик)', Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (blog), 1 mars 2024, <https://bit.ly/43Wd8fl>.

111 'U nënshkrua një Memorandum bashkëpunimi midis Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Drejtorisë së Policisë Financiare (Потпишан меморандум за соработка помеѓу Државната комисија за спречување на корупција и Управата за финансиска полиција)', Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (blog), 26 mars 2024, <https://bit.ly/3VZBH8S>.

112 "'Ne po navigojmë ndërsa në korridor ka argumente dhe zënka - si nuk u rrezikua trafiku ajror?!' Kontrollorët e trafikut ajror dëshmojnë ndërhyrjen e bandës Nezir (,,Ние навигираме, а во ходникот викотници и тепачки - и како не бил загрозен авиосообраќајот?!' Контролори на летање сведочат за упадот на бандата на Незири)', Plusinfo.Mk, 9 janar 2024, <https://plusinfo.mk/nie-navigirame-a-vo-hodnikot-vikotnici-i-tepachki-i-kako-ne-bil-zagrozen-aviosoobra-a-ot-kontrolo-ri-na-leta-e-svedochat-za-upadot-na-bandata-na-neziri/>.

113 'Dikush nuk do të fluturojë - drejtorët ose aeroplanët (Некој нема да лета - директорите или авионите)', Radio Evropa e Lirë, 9 janar 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/nekoi-nema-da-leta---direktorite-ili-avionite-/32767014.html>.

114 'Drejtorët në M-NAV u shkarkuan njëzëri, drejtori i ri është Ilir Memedi (Едногласно разрешени директорите во М-НАВ, нов извршен Илир Мемеди)', Kanal 5, 9 janar 2024, <https://kanal5.com.mk/kanal-5-doznava-ednoglasno-razresheni-direktorite-vo-m-nav-nov-izvrshen-ilir-memedi/a620178>.

115 'Ministrat mohojnë se kanë ndikuar në punësimin në M-NAV (Министрите негираат дека влијаеле при вработувањата во М-НАВ)', Deutsche Welle, 17 janar 2024, https://www.dw.com/mk/ministrite-negiraat-nepotizam-damkata-za-vrabotuvanata-vo-mnav-ostanuva/a-68007644?maca=maz-rss-maz-pol_makedonija_timemk-4727-xml-mrss.

116 'Kovačevski: M-NAV është bërë një kompani familjare, ne duhet të merremi më seriozisht me të (Ковачевски: М-НАВ станала семејна фирма, треба посериозно да се позанимаваме со неа)', Nezavisen.Mk, 9 janar 2024, <https://nezavisen.mk/kovacevski-m-nav-stanala-semejna-firma-treba-poseriozno-da-se-pozanimavame-so-nea/>.

të Inspektoratit të Punës.¹¹⁷ Delegacioni i BE-së kërkoi hetime për akuzat për nepotizëm dhe dhunën ndaj personelit që punon në M-NAV.¹¹⁸ Më pas, u emëruan drejtorë të rinj të M-NAV,¹¹⁹ dhe Agjencia e Aviacionit Civil kreu mbikëqyrje të jashtëzakonshme të M-NAV, duke zbuluar një sërë shkeljesh të rënda dhe mosrespektim të dispozitave ligjore në fushën e sigurisë dhe duke vendosur 11 masa të detyrueshme për M-NAV, si dhe urdhra për kundërvajtje dhe sanksione për personin juridik dhe individët.¹²⁰ Në bazë të hetimit të PP-së, gjykata vendosi arrest shtëpiak ose paraburgim për autorët e ndërhyrjes së dhunshme në M-NAV, dhe të gjithë u arrestuan.¹²¹

Lidhur me hetimin e marrëveshjes për ndërtimin e korridoreve 8 dhe 10-d të lidhur me “Behtel dhe Enka”, Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (PTHPNKOK) ka njoftuar se gjatë dhjetë muajve të fundit është mbledhur dokumentacion i gjerë, disa persona janë thirrur për t’u marrë në pyetje, dhe ka vazhduar bashkëpunimi me Entin Shtetëror të Revizionit. Megjithatë, hetimi ende nuk ka dhënë një rezultat përfundimtar. PTHPNKOK deklaroi se kjo është për shkak të përmasës së lëndës dhe burimeve të tyre të kufizuara. Aktualisht, vetëm një hetues është caktuar për lëndën nga gjithsej 20 në institucion.¹²²

Pas një hetimi të gjatë, PTHPNKOK ngrii aktakuzë kundër Kryetarit të Komunës së Strugës për blerjen e një makine luksoze në kurriz të buxhetit të Komunës së Strugës. Ai akuzohet për shpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar sipas nenit 353, pika 4 të Kodit Penal, i cili parashikon dënimin me burgim nga një deri në pesë vjet nëse dënohet.¹²³ Gjykata Themelore Penale Shkup deklaroi se juridiksioni i takon gjykatës ku është kryer krimi. Prandaj, ajo e ridrejtoi lëndën në Gjykatën Themelore në Strugë.¹²⁴

Në rastin “Titanik”, Gjykata e Apelit Shkup dha lirim me kusht për ish-ministrin e Transportit dhe Komunikacionit, i cili do të lirohet në qershor. Nga ana tjetër, gjykata nuk e ka miratuar një vendim të tillë në këtë lëndë në lidhje me ish-drejtesin e ish-Drejtorisë së Sigurisë dhe Kundërzbulimit. Megjithatë, ajo e mbështeti ankesën e tij dhe e ktheu lëndën për rigjykim në Gjykatën Themelore Penale Shkup.¹²⁵

Në rastin “Thesari”, ish-drejtesi i Drejtorisë së Sigurisë dhe Kundërzbulimit u akuzua për keqpërdorim të fondeve nga buxheti i shtetit për blerjen e pajisjeve të komunikimit elektronik për nevojat e institucionit. Gjykata vendosi lirimin e tij pasi prokurori publik nuk dëshmoi përtej dyshimit të arsyeshëm se ai dhe personat e tjerë të akuzuar kryen veprën penale për të cilën u akuzuan.¹²⁶

117 ‘Inspektorati i Punës do të inspektojë sindikatat në M-NAV: “Ajo kompani është kompani familjare, vëllai i Tasevskit punon atje, babai i tij ka punuar atje” (Трудова ќе ги проверува синдикатите во М-НАВ: „Таа фирма е семејна, брат му на Тасевски работи таму, татко му работел таму“), A1 On, 10 January 2024, <https://a1on.mk/macedonia/trudova-ge-gi-proveruva-sindikatite-vo-m-nav-taa-firma-e-semejna-brat-mu-na-tasevski-raboti-tamu-tatko-mu-rabotel-tamu/>.

118 ‘Delegacioni i BE-së: Ne presim që autoritetet shtetërore të hetojnë pretendimet për kronizëm në punësim në M-NAV (Делегација на ЕУ: Очекуваме државните власти да ги истражат наводите за кронизам во вработувања во М-НАВ); 360 Stepeni, 9 janar 2024, <https://360stepeni.mk/delegatsija-na-eu-ochekuvame-drzhavnite-vlasti-da-gi-istrazhat-navodite-za-kronizam-vo-vrabotuvana-vo-m-nav/>.

119 ‘M-NAV ka drejtues të ri - Milan Koraq, Kryetar i Bordit Drejtues (M-NAV има ново раководство – Милан Кораќ претседател на Управниот одбор); Mkd.Mk, 26 janar 2024, <https://mkd.mk/m-nav-ima-novo-rakovodstvo-milan-korak-pretседател-na-upravniot-odbor/>.

120 ‘Inspektimi: 11 rekomandime të detyrueshme të sigurisë në M-NAV (Надзор: 11 задолжителни препораки за безбедноста во М-НАВ); Deutsche Welle, 25 janar 2024, https://www.dw.com/mk/vonreden-nadzor-seriozni-propusti-i-preksuvana-na-procedurite-za-bezbednost-vo-mnav/a-68069754?maca=maz-rss-maz-pol_makedonija_timemk-4727-xml-mrss.

121 ‘Тë gjithë të dyshuarit për ndërhyrjen në M-NAV u arrestuan, një person mori paraburgim (Уапсени сите осомничени за упадот во М-НАВ, едно лице доби затворски притвор); Radio Evropa e Lirë, 18 janar 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/32782370.html>.

122 ‘Po ripojmë mbi lëndën për mbikëqyrjen e “Bechtel dhe Enka”-me një hetues dhe një tufë dokumentesh (Се работи на предметот за надзорот над „Бехтел и Енка” – Со еден истражител, а куп документи); 360 Stepeni, 1 mars 2024, <https://360stepeni.mk/se-raboti-na-predmetot-za-nadzorot-nad-behtel-i-enka-so-eden-istrashitel-a-kup-dokumenti/>.

123 ‘PTHPNKOK pas një hetimi afatgjatë, ngrii aktakuzë kundër Ramiz Merkos për blerjen e “Audi-së” luksoze (ОЈО ГОКК по долга истрага поднесе обвинение против Рамиз Мерко за набавката на луксузното „ауди”); 360 Stepeni, 1 mars 2024, <https://360stepeni.mk/ojo-gokk-po-dolga-istraga-podnese-obvinenie-protiv-ramiz-merko-za-nabavkata-na-luksuznoto-audi/>.

124 ‘Gjykata Themelore Shkup u deklarua e paaftë për akuzën kundër Ramiz Merkos, lënda iu dërgua gjykatës në Strugë (Скопскиот суд се прогласи за ненадлежен за обвинението против Рамиз Мерко, предметот е препратен до судот во Струга); 360 Stepeni, 6 mars 2024, <https://360stepeni.mk/skopskiot-sud-se-proglasi-za-nenadlezhen-za-obvinenieto-protiv-ramiz-merko-predmetot-e-prepraten-do-sudot-vo-struga/>.

125 ‘Gjykata e Apelit: Janakieski do të lirohet në qershor, dhe Gjykata Penale do të vendosë për lirimin me kusht të Mijallkovit (Апелација: Јанакиески во јуни излегува на слобода, а за условен отпуст на Мижалков ќе одлучува Кривичен суд); 360 Stepeni, 12 mars 2024, <https://360stepeni.mk/apelatsija-janakieski-vo-juni-izleguva-na-sloboda-a-za-usloven-otrust-na-mijalkov-ke-odluchuva-krivichen/>.

126 ‘Mijallkov, Grujovski dhe Jakimovski morën shfajësim në rastin “Thesari” (Мижалков, Грујовски и Јакимовски добија ослободителна пресуда во случајот „Трезор”); 360 Stepeni, 22 shkurt 2024, <https://360stepeni.mk/mijalkov-grujovski-i-jakimovski-dobija-osloboditelna-presuda-vo-sluchajot-trezor/>.

Kuadri Ligjor

Ministria e Punëve të Jashtme ka propozuar ndryshime në Ligjin për Masat Kufizuese për të përfshirë aktet ligjore nga Shtetet e Bashkuara dhe Mbretëria e Bashkuar si bazë për vendosjen e masave të tilla në Maqedoninë e Veriut. Kjo iniciativë synon të zgjerojë fushën e masave dhe mjeteve kufizuese në dispozicion, duke shtuar korrupsionin dhe abuzimin e detyrës zyrtare së bashku me terrorizmin dhe përhapjen e armëve.¹²⁷ Propozimi pason një rritje në përfshirjen e zyrtarëve publikë të mëparshëm ose aktualë, duke përfshirë një ish-prokuror të posaçëm publik dhe Kryetarin aktual të Komunës së Karposhit dhe familjet e tyre në “listën e zezë” të SHBA.¹²⁸

Për të luftuar korrupsionin në pikat e kontrollit kufitar, Këshilli Kombëtar për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit ka sugjeruar ndryshimin e Ligjit për Policinë Kufitare. Ky ndryshim do të paraqiste testimin poligrafik për oficerët e kontrollit kufitar si një masë anti-korrupsion. Një institucion i pavarur do të kryente testimin dhe dështimi i testit do të rezultonte në shkarkim të menjëhershëm, pasuar nga hetim i mëtejshëm nga PP.¹²⁹

127 “‘Lista e zezë’ e SHBA-së do të bëhet baza për sanksione edhe në vend (Amerikanskata „црна листа“ ќе стане основ за санкции и во земјава), 360 Stepeni, 11 janar 2024, <https://360stepeni.mk/amerikanskata-tsrna-lista-ke-stane-osnov-za-sanktsii-i-vo-zemjava/>.

